DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 020 - 409/4
-VI- Data / Datum / Date 24.04.2019

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Për :** | **Shaban Shabani**, Kryetar i Komunës së Dragashit<br>**Betim Merdiu**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Dragashit | |
| **Cc:** | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| **Përmes:** | **Adrijana Hodžić**, Ministre e MAPL-së<br>**Rozafa Ukimeraj**, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| **Nga:** | **Venera Çerkini**, U.d. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL | Data:15.04.2019<br>Nr. 020-409 |
| **Lënda:** | Konfirmim i ligjshmërisë së Aktit të Komunës së Dragashit | |
| **Lloji i aktit:** | Vendim | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim Nr. 0601- 59362 për Planit të Transparencës për Komunën e Dragashit 2019-2023 |
| I miratuar më datë: 02.04.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë:15.04.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALGSH-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020 - 409/4
-VI-
Data Datum Date 24. 04. 2019

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Za:** | **Shaban Shabani**, gradonačelnik opštine Dragaš<br>**Betim Merdiu**, predsedavajući Skupštine opštine Dragaš | |
| **Kopija:** | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini | |
| **Preko:** | **Adrijana Hodźić**, ministarka MALS-a<br>**Rozafa Ukimeraj**, generalna sekretarka MALS-a | |
| **Od:** | **Venera Çerkini**, v.d rukovodilac pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS | Dana: 15.04.2019<br>Br. 020-409 |
| **Predmet:** | Potvrda zakonitosti akta opštine Dragaš | |
| **Vrsta akta:** | Odluka | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka br. 0601- 59362 za plan transparetnosti za opštinu Dragaš za period 2019-2023 |
| Usvojen dana: 02.04.2019. godine |
| Dostavljen MALS-u za razmatranje dana: 15.04.2019. godine |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samoupravе i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 15.04.2019
-VI- 020-409

- Kuvendi Komunal
01 Nr.060/1-5936/2
Dt.02.04.2019
D r a g a s h

Në bazë të nenit 167 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32.2. të Statutit të Komunës së Dragashit, në seancën e III-të/2019 të Kuvendit Komunal të Dragashit, të mabjtur më 02.04.2019, pas shqyrtimit paraprak, miratohet ky:

# V E N D I M

I. **MIRATOHET** Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Dragashit (2019-2023).

II. Për implementimin e këtij Vendimi dhe vërejtjet e dhëna për Raportin obligohen Kryetari, në bashkëpunim me drejtoratet dhe shërbimet e Komunës-Dragash.

III. Për hapat e ndërmarr njoftohet Kuvendi Komunal-Dragash.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Protokolin e MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web-faqen e Komunës së Dragashit.

I dërgohet :
- Kryetarit të Komunës Dragash z.Shaban Shabani,
- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë, dhe
- Arkivit

**KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH**
**K r y e s u e s i**
***Betim Merdiu***

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO**

**REPUBLIK OF KOSOVO**

**Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash**

# PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E DRAGASHIT

# (2019 – 2023)

**Dragash,02.04.2019**

| | Objektivat e planit të veprimit të transparencës | Aktivitet e planit të transparencës | Njësia / apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të Komunës | Vendi i mbajtjes të aktiviteteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunale | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mbledhjet e rregullta te kuvendit Komunale dhe të Komiteteve | Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit Komunal dhe komiteteve në : | Sekretaria e Kuvendit , njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik, | Salla e Kuvendit Komunal | Njoftimi për mbledhjet e rregullta te Kuvendit Komunal është 7 ditë pune para mbajtjes së tyre | |
| | | Faqe zyrtare dhe dërgimi i thirrjeve bashku me materialin delegatëve | | | | |
| | | në vendet më të frekuentuara në komunë | | | | |
| | | në media të shkruar elektronike | | | | |
| | | Në radio lokale | | | | |
| 2 | Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal | Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit Komunal dhe komiteteve në : | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton | Salla e Kuvendit Komunal apo edhe në zyren e Nënkryetarit . | Njoftimi për mbledhjet e jashtëzakonshme te Kuvendit Komunal është 3 ditë për para | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Faqe zyrtare | qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik. | | | |
| | | në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës; | | | | |
| | | Dërgimi i thirrjeve bashkë me materialin delegatëve | | | | |
| | | ne media te shkruar | | | | |
| | | | | | | |
| | | elektronike dhe hapësira administrative te Komunes | | | | |
| | | Radio lokale | | | | |
| 3 | **Konsultimet me publikun** | Komuna organizon Konsultime të ndryshme çka janë në interes të qytetarëve | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik, | -Në sallë e kuvendit Komunal -në objekte me hapësirat të mjaftueshme nëpër fshatra dhe vendbanime të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut. | Njoftim për konsultime me publikun , publikohen dy jave para seancës së konsultimeve | |
| | | Konsultimet për buxhet lokal | | | | |
| | | | Njoftimi bëhet : | | | |
| | | | Në web faqe zyrtare | | | |
| | | | Në media të shkruar dhe elektronike | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Konsultimet për zhvillimin ekonomik lokal | në vendet më të frekuentuara në qytet dhe në fshatra të komunës<br>Në radio lokale në territorin e komunës | | | |
| | | Konsultimet për zhvillimin ekonomik lokal | | | | |
| | | Konsultimet për planifikimin hapësinor | | | | |
| | | Konsultimet për investimet, | | | | |
| | | Konsultimet për të hyrat komunale | | | | |
| | | Konsultimet për çështje të tjera në interes të përgjithshëm për qytetarët si që janë investimet nga komuna dhe investues të jashtëm | | | | |
| 4 | Takimet me publikun | Komuna mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton | - i pari në Qershor<br>– i dyti dhjetor | Njoftim për konsultativet me publikun , publikohen dy javë para seancës së konsultimeve | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. | qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik, | -Dhe sipas rasteve dhe nevojave | | |
| | | Përveç dy takimeve publike, Kuvendi i Komunës duhet të shqyrtoi mundësin për të mbajtur takime shtesë, dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm | Njoftimi bëhet : | | | |
| | | | Në web faqe zyrtare | | | |
| | | | Në media të shkruar dhe elektronike | | | |
| | | | në vendet më të frekuentuara brenda në objekt të komunës dhe territorit të saj | | | |
| | | | Radio lokale komunale | | | |
| | | Takimi për zhvillimin ekonomik lokal, | | | | |
| | | | | | | |
| | | Takim për përdorimin e pronës komunale | | | | |
| | | Takim për planifikimin hapësinor | | | | |
| | | Takimi për investime dhe të hyrat komunale | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 5 | **Takime dhe Intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ-t dhe gazetar** | Kryetari i komunës në kuadër të kompetencave të tij duhet të realizojë takime me qytetarët<br><br>Takimet në formë debati me qytetarët ,<br><br>Takime Njoftimi, pyetje e përgjigje,<br><br>intervista , konfernca per media etj. | Shefi i kabinetit të kryetarit përmes zyrtarit për komunikim apo Zyrtari përgjegjës për informim Drejtori i Dep. perkates | Në sallë e kuvendit Komunal ose në objekte me hapësirat të mjaftueshme brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë në zyre te radio apo tv<br><br>Njoftimi për takime e kryetarit me publikun publikohet në<br><br>Faqe zyrtare<br><br>në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës | Njoftimi për qytetarët lidhur takimet dhe intervistë me kryetarin e komunes duhet të bëhet dy jave ditë para takimet apo intervistës | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ne media te shkruar dhe elektronike | | |
| | | | | apo edhe në rrjetet sociale | | |
| | | Kryetari I komunës cakton nje dite brenda javës që në zyrën e tij te ketë takime me qytetarët | | Radio lokale apo edhe në hapësira të hapura | | |
| | | | | Fshihet shpallja publike | | |
| | | | | Rrjeteve sociale | | |
| 6 | **E drejta e qasjes në dokumente publike** | Kërkesat për qasje në dokumente trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin e mbikëqyrë informatën.<br><br>Institucioni publik ndihmon kërkuesin, aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë, të | Njësia/zyrtari për komunikim me qytetarët është dhe bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje ne dokumentet publike të aprovuar nga organet e Komunës dhe i adreson në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike | Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike | Komuna obligohet që brenda shtatë (7) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës të nxjerrin vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japin përgjigjeje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishme dhe informon kërkuesin për të drejtën e tij. | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | identifikojë dokumentin e kërkuar. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare trajtohen në mënyrë të barabartë. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare shqyrtohet dhe trajtohet me shpejtësi. | dhe aktet nënligjore të zbatueshme | | Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë, në qoftë se dokumenti publik kërkohet jashtë organeve të komunës, dhe nëse përmes një kërkesës kërkohen disa dokumente publike. | |
| 7 | **Kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe peticioni** | subjektet fizik ose juridik ka të drejtë të parashtroi kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciativat qytetare dhe peticion për çështje që janë përgjegjës organet e Komunës.<br>Partneritet qytetarë – komunë | Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës Kryetari i Komunës ose njësia/zyrtari për komunikim me qytetarët, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit. | Kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe peticioni parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim | Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh siç është e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale | |
| | | Mbështetje e iniciativave qytetarë | | | | |
| | | Investime në interes të përgjithshëm ku participimi është bashke me qytetarët | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mbështetje OJQ-ve për realizimin e aktiviteteve në interes të përgjithshëm<br><br>Përfshirja e qytetarëve në komisione të ndryshme<br><br>Informimi i qytetarëve me kohë lidhure me kërkesat e parashtruara | | | | |
| 8 | **Publikimi i akteve Komunale** | Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimin e ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | Zyrtari përgjegjës për informim përmes njësive që posedojnë dokumentacione | Të gjitha aktet nënligjore dhe dokumenteve tjera publike duhet të publikohet në web<br><br>faqe të komunës Publikim bëhet<br><br>Në web faqe zyrtare të komunës<br><br>Medieve të shkruara dhe elektronike lokale | Aktet nën –ligjore të komunave publikohet në faqe zyrtare 15 ditë pas regjistrimit në arkivin e Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal ndërsa aktet tjera juridike publikohen pas hyrjes në fuqi | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në vende të frekuentuar brenda territorit të komunës | | |
| | | | | Apo në rrjete sociale | | |
| 9 | **Freskimi i ueb faqes zyrtare të Komunave** | Ueb-faqen zyrtare e Komunës të saj ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 | Obligohen njësit përgjegjëse për komunikim me publikun ose zyrtarët e ngarkuar me këtë detyrë në institucionet përkatëse publike që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ. | Ueb faqja e institucionit publik gjithashtu duhet të ketë: Hartën e Faqes (strukturën e faqes); Lidhja (linku) me portalin shtetëror dhe ueb faqet e institucioneve vartëse; Lidhjen (linkun) me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës | Mirëmbajtja ueb-faqen zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015<br>Caktimi i zyrtarit përgjegjës për mirëmbajtjen e Ueb-faqes | |
| | | Ueb faqja duhet të jetë e kompatibile me shfletuesit më të kërkuar në internet<br><br>Ueb faqja duhet të jetë e lehte për shfletim. | | | | |
| | | Arritja deri te informacionet në ueb faqe të jete me sa më pak hapa-klikime. | | | | |
| 10 | Qasja e Shërbimeve për | Certifikata të lindjes<br>Çertifikata të vdekjes<br>Çertifikata të kurorëzimit, | Njësia përkatëse me zyrtarin e TI-se se | Te jene formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duhet | Ne ëeb faqe zyrtare te linku i shërbimeve për qytetarët publikohen edhe procedura për | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **qytetarët transparente dhe shpejtë** | Çertifikata të statusit martesor,<br>Dëshmi për personin që është gjallë,<br>Dëshmi për vdekjen, e cila u shërben qytetarëve për trashëgimi<br>Vërtetimin që është mbajtës i familjes,<br><br>Regjistrimi i lindjeve,<br><br>Regjistrimi i vdekjeve,<br><br>regjistrimi i kurorëzimeve nga bota e jashtme për të gjitha komunat e Kosovës, si dhe Çertifikatat mbi bashkësitë familjare | bashku me zyrtarin përgjegjës | publikuar në eeb faqen zyrtare , ku qytetari ta ketë qasjen e lehte | shërbime dhe afate e caktuar për kryerjen e shërbimeve , Oarari i punës të organeve komunale dhe adresat dhe numrat e telefonave për kontaktim | |
| 1 | **Prokurimi transparent** | Njoftim për kontratë<br><br>Njoftim për dhënien e kontratës<br><br>Njoftim për konkurs të projektimit | Zyra e prokurimit në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për komunikime | Të njoftime nga fusha e prokurimit bëhen publike në eeb faqe zyrtare të komunës dhe në media të shkruar dhe elektronike | Njoftimeve dhe dokumenteve të tjera të prokurimit të publikohen duke i respektuar afatat ligjore | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Njoftim për anulim | | | | |
| | Njoftimi për vazhdimin e afatit | | | | |
| Procedurat e punësim transparente për qytetarët | Shpallja e konkurseve<br>Njoftimi për përzgjedhjen e kandidateve<br>Njoftimi për anulimin e konkursit<br>Rishpallja apo vazhdimi i konkursit<br>Avancimet brenda institucionit Aplikacionet për punësim | Pergjegjës për publikimin e procedurave të shërbimit civil eshtë zyra e personelit së bashku me zyrtarin për komunikim | Publikimi i të gjithave procedurave në shërbimin civili publikohen ne ëeb faqe zyrtare të komunës , në objektin e komunës ne media te shkruar dhe elektronik , publikim duhet të jete edhe te institucionin përgjegjës për shërbimin civil | Publikimi dhe zbatimi i procedurave të shërbimit civil bëhet në përputhje me legjislacioni e shërbimit civili<br>Afatet për shpailjen e konkursit , njoftimit te kandidateve , vazhdimi i konkurseve, anulimi i konkurseve etje | |

01 Nr. 060/1-5936/2
Datë:02.04.2019

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH
KRYESUESI:
BETIM MERDIU

**Ardita Latifi**

---

**From:** Gafurr Sllamniku
**Sent:** Wednesday, April 17, 2019 3:15 PM
**To:** Ardita Latifi
**Subject:** FW: Plani per tranpsarence per vlersim
**Attachments:** Vendime nge seanca e 3-1.pdf

---

**From:** Gafurr Sllamniku
**Sent:** 15. april 2019 13:48
**To:** Ardita Latifi <Ardita.Latifi@rks-gov.net>
**Cc:** Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
**Subject:** FW: Plani per tranpsarence per vlersim

E nderuar,

Ju lutem shiheni a është ne harmoni me legjislacionin ne fuqi plani transparencës per KK-Dragash per procedim tutje te sekretarja, me informoni me shkrim si divizion kompetent.

Me respekt,
Gafurri.

---

**From:** Gafurr Sllamniku
**Sent:** 12. april 2019 11:31
**To:** Shkrimorja Mapl <Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net>
**Cc:** Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
**Subject:** Aktet per protokollim KK-Dragash

Të nderuara,

Bashkangjitur gjeni Aktet per protokollim KK-Dragash

***Me të Mira.***

**(LL.M) Gafurr Sllamniku**
**Zyrtar për Monitorim të Komunave**
**Qerveria e Republikës së Kosovës**
**Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal**
**Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave**

Republika e Kosovës

| PHONE | MOBILE | EMAIL |
| --- | --- | --- |
| **+383 38 200 35659** | **+383 45 231 409** | **gafurr.sllamniku@rks-gov.net** |

Adresa: Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë ' Ish Rilindja ' Kati 11/1117

---

Ky mesazh është konfidencial. Nëse keni pranuar këtë mesazh gabimisht, ju lutem na njoftoni menjëherë me e-mail dhe fshini atë nga sistemi juaj. Ju nuk mund të kopjoni këtë mesazh ose të bëni publik përmbajtjen e tij.
This message is confidential. If you have received it by mistake, please let us know by e-mail reply and delete it from your system; you may not copy this message or disclose its contents to anyone.